



KOMUNA  
**RAHOVEC**

RAPORTI  
GJASHTËMUJOR I  
PUNËS SË KRYETARIT,  
JANAR- QERSHOR

Qershor 2024

**PËRMBAJTJA**

<b>KRYETARI I KOMUNËS .....</b>	<b>2</b>
<b>ZOTIMET .....</b>	<b>3</b>
<b>PRIORITETET E PROGRAMIT QEVERISËS.....</b>	<b>3</b>
<b>PRIORITETET KRYESORE PËR VITIN 2024.....</b>	<b>3</b>
<b>SYNIME PËR VITIN 2024 .....</b>	<b>5</b>
<b>SFIDAT KRYESORE PËR VITIN 2024.....</b>	<b>5</b>
<b>Zyra Ligjore.....</b>	<b>6</b>
<b>Zyra e Burimeve Njerëzore - Njësia e Personelit.....</b>	<b>6</b>
<b>Zyra e Prokurimit.....</b>	<b>7</b>
<b>Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun.....</b>	<b>7</b>
<b>Zyra e Auditimit të Brendshëm .....</b>	<b>7</b>
<b>Zyra Komonale për Komunitete dhe Kthim.....</b>	<b>8</b>
<b>Zyra për Përfaqësim Ligjor - Avokatura .....</b>	<b>8</b>
<b>DREJTORIA PËR ADMINISTRATË.....</b>	<b>11</b>
<b>Spektori i Gjendjes Civile.....</b>	<b>11</b>
<b>Spektori për Punë të Kuvendit dhe të Komiteteve .....</b>	<b>12</b>
<b>Spektori për IT .....</b>	<b>12</b>
<b>Qendra për Shërbime me Qytetarë .....</b>	<b>13</b>
<b>Spektori për Barazi Gjinore.....</b>	<b>13</b>
<b>DREJTORIA PËR FINANCA DHE BUXHET .....</b>	<b>13</b>
<b>DREJTORIA PËR ARSIM.....</b>	<b>15</b>
<b>Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale .....</b>	<b>16</b>
<b>DREJTORIA PËR EKONOMI, ZHVILLIM DHE TURIZËM.....</b>	<b>17</b>
<b>DREJTORIA PËR URBANIZËM, PLANIFIKIM DHE MBROJTJE TË MJEDISIT .....</b>	<b>18</b>
<b>DREJTORIA PËR SHËRBIME PUBLIKE .....</b>	<b>19</b>
<b>DREJTORIA PËR BUJQËSI, PYLLTARI DHE ZHVILLIM RURAL.....</b>	<b>19</b>
<b>DREJTORIA PËR GJEODEZI, KADASTËR DHE PRONË .....</b>	<b>22</b>
<b>DREJTORIA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT.....</b>	<b>23</b>
<b>DREJTORIA PËR PUNË INSPEKTUESE.....</b>	<b>24</b>
<b>DREJTORIA PËR MBROJTJE DHE SHPËTIM.....</b>	<b>25</b>
<b>PËRFUNDIM .....</b>	<b>26</b>

**KRYETARI I KOMUNËS****Fjala hyrëse**

*Qytetarë të komunës së Rahovecit,*

*Bazuar në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 dhe Statutin e Komunës së Rahovecit, Nr.1005, i datës 29.3.2017, si dhe në Planin e Punës së Kryetarit të komunës dhe Qeverisë komunale 2023, kemi kënaqësinë të paraqesim para jush raportin gjashtëmuor për punët, angazhimet dhe arritjet e Komunës së Rahovecit për periudhën: janar – qershor 2023.*

*Raporti pasqyron të gjitha aktivitetet dhe angazhimet e drejtorive komunale në komunën e Rahovecit, si dhe të njësive të cilat veprojnë në kuadër të Zyrës së kryetarit të Komunës së Rahovecit, njëkohësisht reflekton angazhimin dhe rezultatet e shënuara në këtë periudhë.*

*Ky raport gjithëpërfshirës ka për qëllim të nënvizojë progresin e arritur në realizimin e prioritetëve të komunës dhe ka si pikë reference Programin e Qeverisë Komunale.*

*Jemi angazhuar fuqishëm që të arrijmë nivel më të lartë të transparencës komunale dhe në vazhdimësi jemi përkujdesur që praktikat më të avancuara demokratike, të aplikohen gjatë vendimmarrjes në Qeverinë komunale. Raporti gjashtëmuor i punës është mjet i komunikimit i të arriturave të pushtetit lokal, i përkushtimit, i angazhimit dhe i vendosmërisë së treguar në përmbushjen e detyrave dhe të obligimeve, me qëllim të rritjes së mirëqenies së qytetarëve të komunës së Rahovecit.*

**ZOTIMET**

- Komunë e hapur për qytetarët, transparencë e plotë dhe llogaridhënie;
- Komunë që qeveriset drejt dhe mirë, ligjshëm dhe me performancë të lartë;
- Komunë që u shërben qytetarëve pa dallim;
- Komunë me shërbime gjithnjë e më bashkëkohore;
- Komunë ku promovohen politikat dhe praktikat më të mira, si dhe standardet e larta të qeverisjes;
- Komunë ku respektohen vlerat njerëzore e qytetare;
- Komunë pa diskriminim, e që qytetarët i trajton barabartë;
- Komunë ku respektohen vlerat kombëtare, historike, vlerat e luftës dhe të lirisë;
- Komunë që nderon sakrificën dhe gjakun e derdhur për liri;
- Komunë që trajton dhe mbështet qytetarët që kanë nevoja të veçanta;
- Komunë që nderon, promovon e i jep përkrahje traditës, trashëgimisë dhe gjithë pasurisë sonë të përbashkët, gjithë asaj që është vlerë dhe identitet i Rahovecit;
- Komunë ku përfaqësohet, mbrohet dhe punohet për interesin publik;
- Komunë ku përkushtimi për të vepruar ndershëm dhe në pajtim me ligjin, veçse vullnet, përcaktim i të zgjedhurve, jetësohet edhe si detyrim moral ndaj zgjedhësve si dhe ndaj ligjit;
- Komunë ku respektohet mozaiku i vlerave njerëzore, demokratike, kulturore, të trashëgimisë e të besimit në Zot;
- Komunë ku respektohen pakicat dhe promovohen vlerat e tyre.

**PRIORITETET E PROGRAMIT QEVERISËS**

- Bujqësia;
- Ekonomia, agroturizmi dhe punësimi;
- Administratë bashkëkohore me shërbime të shpejta dhe cilësore;
- Arsimi, shëndetësia dhe përkujdesja sociale;
- Infrastruktura publike të rregulluar dhe të mirëmbajtur;
- Investime nga fondi i eficientësisë së energjisë në sektorin publik dhe privat;
- Investime në infrastrukturë kulturore, sportive dhe hapësira për të rinjtë si dhe rritja e përkrahjes për këta sektorë;
- Promovimi i potencialit dhe i mundësive për investime nga mërgata jonë;
- Trashëgimia kulturore, historike dhe investime për ta nderuar hartën e sakrificës dhe të lirisë.

**PRIORITETET KRYESORE PËR VITIN 2024**

- Sheshi Qendror i Qytetit;
- Funkcionalizimi i Shtëpisë për të Moshuar;
- Funkcionalizim, mirëmbajtje dhe menaxhim të Maja e Shkodranit;
- Mirëmbajtje dhe menaxhim i Kullës për heronjtë Xhelal Hajda-Toni, Selajdin Mullabazi-Mici dhe bashkëlufëtaret e tyre, Hamdi Hajrizi, Nezir Imeri dhe Bektesh Haliti në Opterushë;
- Edukim dinjitoz i brezave të rinj, duke iu ofruar mësimdhënie dhe mësimnxënie cilësore bashkëkohore, mjedis të përshtatshëm mësimor me infrastrukturë adekuate dhe gjithëpërfshirëse;
- Funkcionalizim i plotë i çerdheve ekzistuese;
- Bursa për studentë;
- Bibliotekat – kujdes i shtuar për bibliotekat, duke u përkujdesur për blerjen e titujve të rinj, por edhe duke i mirëmbajtur dhe investuar në objektet e bibliotekave ekzistuese;

- Laboratorë dhe kabinete – do të investojmë në zhvillimin dhe krijimin e laboratorëve të rinj për shkencat natyrore dhe në kabinete;
- Përkrahje e fermerëve me serra, stalla, ferma të vogla, inpute dhe pajisje bujqësore;
- Rrugë fushore;
- Përkrahje për pikat grumbulluese të qumështit;
- Kanale të kullimit të tokave bujqësore;
- Shërbime veterinarë periodike, falas;
- Konsulencë dhe hartim të projekteve falas për bujq dhe biznese;
- Ndërtim i rrugëve të reja dhe mirëmbajtja e rrugëve ekzistuese;
- Në bashkëpunim me KEDS-in, angazhim për furnizim stabil me energji, ndërrim i rrejtës, i shtyllave, instalime nëntokësore etj.;
- Bashkëpunim me KRU “Gjakova” dhe donatorë të tjerë për furnizim më të mirë me ujë të pijshëm;
- Eficienca e energjisë në objekte publike dhe në sektorin privat, përmes fondit të mileniumit;
- Mirëmbajtje e rregullt e hapësirave publike, e objekteve publike dhe e të gjitha llojeve të investimeve publike në komunën e Rahovecit;
- Legalizimi i parkingjeve ekzistuese dhe krijimi i parkingjeve të reja;
- Rregullimi i infrastrukturës për persona me nevojë të veçanta;
- Trajtimi i ujërave të zeza dhe i rrugëve në pjesë problematike të qytetit;
- Mjedisë të bukura dhe hapësira për të rinjtë;
- Kënde lojërash për fëmijë;
- Rritje e standardit të shërbimeve shëndetësore, përmes menaxhimit të mirë dhe profesional. Në bashkëpunim me nivelin qendror, do të investohet në pajisje të reja e kapacitete njerëzore, për ta mundësuar rritjen e kapaciteteve dhe të cilësisë së shërbimeve të ofruara;
- Tradita e investimit në sektorin e kulturës, rinisë dhe sportit do të vazhdojë përmes përkrahjes së të rinjve, shoqatave kulturorë-artistike dhe klubeve sportive;
- Do të vazhdojë subvencionimi i projekteve kulturorë-artistike dhe sportive, që janë në interes të komunitetit;
- Vazhdim i zbatimit të strategjisë së zhvillimit ekonomik lokal për komunën e Rahovecit 2021-2025;
- Përkrahje dhe lehtësira për prodhuesit, tregtinë, zejet e veçanta, artizanalet, etj.;
- Trajtim dhe rregullim i shtretërve të lumenjve dhe përrenjve;
- PZHK dhe HZK - do të miratohet Plani Zhvillimor Komunal dhe Harta Zonale e komunës, pas shqyrtimit publik;
- Rritja e kapaciteteve inspektuese për mbrojtjen e mjedisit, për të parandaluar e mbrojtur nga ndotësit e shkatërruesit e tij, me shqiptim të gjobave mandatore;
- Investim në Stacionin e Autobusëve në Rahovec, faza e dytë - instalimi i kabinave inovative në stacionet e pritjes, në qytet dhe fshatra;
- Administratë efikase, e përgjegjshme dhe me shërbime moderne,
- Qeverisje energjike, vepruese dhe vendimmarrje pa vonesë,
- Realizim i suksesshëm i projekteve dhe i buxhetit,
- Realizim i planit të të hyrave komunale,
- Promovimi dhe përmirësimi i mjedisit të Rahovecit si qytet lider për ushtrimin e veprimtarive të bizneseve ekzistuese, zgjerimin e tyre si dhe për ato të reja;
- Bashkëpunim i mirë me donatorët e jashtëm,
- Komunikim dhe bashkëpunim me OJQ - të.

**SYNIME PËR VITIN 2024**

- Bujqësi të përkrahur;
- Riparimi dhe mirëmbajtja e rrugëve fushore;
- Intervenimi në ndërtimin e kanaleve të kullimit dhe drenazhimit të tokave bujqësore;
- Zgjerimi i sistemit të ujitjes në pjesët ku mungon;
- Pastrimi dhe mirëmbajtja e përrrenjve;
- Barna esenciale për qytetarët në nevojë nga buxheti i komunës;
- Investime në rritjen e cilësisë së shërbimeve, zgjerimin e tyre, pajisje mjekësore dhe inventarizim për QKMF-në dhe rrjetin e shërbimeve parësore shëndetësore;
- Arsim cilësor dhe biblioteka, pajisje bashkëkohore, laboratorë, më shumë teknologji informative dhe mjete konkretizimi në shkolla;
- Hartimi i planeve specifike komunale;
- Zhvillim ekonomik dhe punësim nëpërmjet fuqizimit dhe mbështetjes së sektorit privat;
- Investime për zhvillimin e planifikuar të agroturizmit;
- Rritjen e të hyrave vetanake përmes lëshimit të lejeve ndërtimore, procesit të legalizimit dhe lejeve mjedisore komunale;
- Në bashkëpunim me Drejtorinë e Urbanizmit dhe me Drejtorinë për Punë inspektuese, legalizimi i objekteve pa leje dhe respektimi i ligjit të ri për trajtimin e objekteve pa leje;
- Mbikëqyrje aktive dhe rritje e cilësisë në investimet publike;
- Vazhdimi i evidentimit dhe lirim të pronave të uzurpuara;
- Dyfishim i përpjekjeve për mbrojtje të mjedisit, mbrojtjen e tokave bujqësore, mbrojtjen e pronës publike, parandalimi i ndërtimeve pa leje;
- Planifikimi i masave për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë, në rast të fatkeqësive natyrore dhe të fatkeqësive të tjera;
- Projekte me partneritet publiko-privat;
- Hartimi i planeve, nxjerrja e akteve dhe i rregulloreve të tjera;
- Zhvillimi i Rahovecit në përputhje me planet zhvillimore komunale dhe menaxhimi i burimeve fizike bazuar mbi parimet e shëndosha mjedisore si dhe mbi parimet e partneritetit me mekanizma vendor e ndërkombëtar, për realizimin e vizionit për komunë model me një qeverisje cilësore, efikase dhe llogaridhënëse;
- Vazhdimin e trajtimit të shtretërve të lumenjve dhe të përrrenjve, përmes investimeve kapitale nga komuna e Rahovecit dhe mbështetjes nga Qeveria e Kosovës, me qëllim të mbrojtjes nga vërshimet dhe ruajtjen e mjedisit.

**SFIDAT KRYESORE PËR VITIN 2024**

- Përkrahja e pamjaftueshme e Qeverisë së Kosovës, mungesa e mjeteve të nevojshme financiare nga qeveria qendrore, që i bëjnë investimet më të vështira dhe shkaktojnë vonesa në realizimin e projekteve.
- Përfshirja e sa më shumë qytetarëve, të bizneseve, bujqve, shoqërisë civile etj., në vendimmarrje komunale dhe për ecurinë e zhvillimeve në komunën tonë.
- Mungesa e hapësirave publike në territorin e komunës së Rahovecit.

**Zyra Ligjore**

Vendime për Kryetarin e Komunës	205
Vendime për Kuvendin e Komunës	39
Urdhëresa	49
Autorizime	8
Akte përcjellëse	6
Marrëveshje	2
Propozime për Kuvend	18
Kërkesa	4
Kontrata	3
Konsultime	permanente
Përgjigje në kërkesa	5
Njoftime	2
Vendime për drejtori	9
Deklarata	1
Vërtetime	1
Punë në Komisione	12
<b>Totali i akteve të hartuara për periudhën janar-qershor 2024, nga Zyra Ligjore, është:</b>	<b>364</b>

**Zyra e Burimeve Njerëzore - Njësia e Personelit**

1. REKRUTIMET – 21 konkurse publike, prej të cilave 8 në Shërbimin Civil, 14 në Drejtorinë për Arsim, si dhe dy në Drejtorinë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale
  2. LËSHIMI I AKTEVE ADMINISTRATIVE - 45 shkresa administrative, si në vijim: Kontrata, vërtetime, vendime, draft-vendime, propozime, akt-emërime, informata, njoftime, kërkesa, raporte dhe shkresa të tjera.
  3. MENAXHIMI I BURIMEVE NJERËZORE SIPAS PROGRAMIT “SIMBNJ”.
  4. ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE ELEKTRONIKE - Menaxhon me programin elektronik *hrms.rks.gov-net*, ku realizohen procedurat e rekrutimit.
- Monitoron sistemin e prezencës (vijueshmërisë) në punët të punëtorëve –pra programin SMVP.  
Menaxhon (një pjesë) me programin SMAED, që në nivel shtetëror është kompetent ASH- Agjencioni i Shoqërisë së Informacionit/MAP.  
Monitoron me programin elektronik PYROLL, pra programin e listave të pagave dhe të pagesave të Komunës.

## Zyra e Prokurimit

Kemi proceduar **dyzet e tri (43)** aktivitete të prokurimit, me vlerë prej: **7,405,411.64 €**;

Janë nënshkruar **tridhjetë e një (31)** kontrata të të gjitha prokurimeve: punë, furnizime, shërbime, ku vlera e kontratave të nënshkruara është: **1,373,493,68 €**;

**Tri (3)** aktivitete të prokurimit janë në ankesë;

**Nëntë (9)** aktivitete të prokurimit janë në procedura të prokurimit, sipas Ligjit të Prokurimit Publik. - Personeli i Zyrës së Prokurimit ka proceduar: **588 urdhërblerja**, pagesa të ndryshme të Investimeve Kapitale, Mallra dhe Shërbime.

## Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun

Në faqen ueb të Komunës janë publikuar të gjitha aktivitetet e mbajtura dhe janë publikuar të gjitha vendimet, raportet, njoftimet, konkurset dhe dokumente të tjera në interes të të gjithë qytetarëve të Komunës. Ka mbajtur kontakte të rregullta me medie, ku u ka përcjellë njoftime e lajme ditore për aktivitetet e zhvilluara në Komunë, ftesa etj.

*Gjatë periudhës gjashtëmujore, janë publikuar aktivitete-dokumente, si në vijim:*

Lajme	Njoftime	Dok financiaree	Thirrje	Konkurse	Plane	Takime/Dë gjime Konsultime	Raporte	Kërkesa QDP	Vendimet e Kryetarit	Aktivite gjithsej
170	65	4	12	18	7	5	20	16	231	<b>548</b>

Të gjitha vendimet e nënshkruara nga kryetari i Komunës, janë dërguar te zyrtarët përkatës në MAPL dhe janë publikuar në faqen ueb zyrtare të Komunës. Për këtë periudhë raportuese, kryetari ka nënshkruar 231 vendime.

## LEKTORIMI

Zyrtarja për Lektorim, ka redaktuar dokumente kryesisht me kërkesë të Kryetarit të Komunës, dokumente nga Njësia e Personelit, nga drejtoritë dhe nga Kuvendi. Për periudhën gjashtëmujore 2024, janë redaktuar rreth 536 dokumente, nga to: vendime, propozime, urdhëresa, raporte, kërkesa, informata, procesverbale etj.

Zyrtarja për lektorim merret edhe me përpilimin dhe përgatitjen për publikim të gazetës zyrtare të Rahovecit, në baza mujore.

## Zyra e Auditimit të Brendshëm

Për periudhën janar – qershor të vitit 2024, kemi arritur të kryejmë dy auditime dhe një është në proces.

**Drejtoritë e audituara të planifikuara dhe të realizuara për periudhën janar – qershor të vitit 2024**

1. Auditimi i Brendshëm në Zyrën e Prokurimit;



2. Auditimi i Performancës, subvencionet në Drejtorinë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural;
3. Auditimi i Brendshëm në Drejtorinë për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm, auditim në proces.

### Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim

- Programi "Qendra Mësimore me bazë në Komunitet" në Shkollën "Gëzim Hamza Piktori".
- Finalizimi i terrenit sportiv në Lagjen e Epërme dhe fillimi i ndërtimit të terrenit sportiv në fshatin Dobidol.
- Vaksinimi i rregullt i fëmijëve në bashkëpunim me UNICEF-in dhe "Balkan Sunflower".
- Inspektimi i procesit të të riatdhësuarve dhe mbështetja e tyre me kushte të mira banimi, mbështetje me qira, plane biznesi, trajnime profesionale dhe ushqime.
- Realizimi për herë të parë i Kampip multietnik "**DIVERSITETI YNË, PASURIA E VENDIT**" me të rinjtë shqiptarë, serbë, romë, ashkali dhe egjiptian nga Rahoveci, Gjakova, Prizreni dhe Shtimja.
- Vendosja e ndriçimit publik dhe e pengesave në vendbanimet e komuniteteve joshumicë, për të penguar shpejtësinë e zhvilluar të automjeteve dhe për të rritur sigurinë e banorëve.

### Zyra për Përfaqësim Ligjor - Avokatura

PASQYRA TABELARE E LËNDËVE SIPAS REGJISTRAVE - PERIUDHA RAPORTUESE								
	Sipas regjistrave të ZPL-së	Civile	Përmbartimore	Konflikt Administrativ	CN Ndryshme	Proc.At_hezionit	Komerciale Ekonomike	Gjithsej lëndë të administruara:
1	Lëndë të pazgjidhura-të bartura	1390	332	13	34	17	5	<b>1791</b>
2	Lëndë të pranuar	641	975	0	0	0	0	<b>1616</b>
3	Të gjitha lëndët në punë	2031	1307	13	34	17	5	<b>3407</b>
4	Lëndë të zgjidhura	326	380	0	0	0	0	<b>706</b>
5	Lëndë të mbetura	<b>1705</b>	<b>927</b>	<b>13</b>	<b>34</b>	<b>17</b>	<b>5</b>	<b>2701</b>

#### 1. LËNDË TË REJA TË PRANUARA GJATË VITIT 2024:

PADI TË REJA SIPAS REGJISTRAVE - PERIUDHA RAPORTUESE

	Lëndë të reja të pranuar gjatë periudhës raportuese	Civile	Përbarim ore	Konflikte Administrative	Civile Ndryshme	Proc.At_hez	Komerciale Ekonomike	Gjithsej lëndë të administrua
1	Vërtetim i pronësisë	10						<b>1</b>
2	Kompensimet sipas Kontratës Kolektive	619	975					<b>1594</b>
3	Konteste pune	4						<b>1</b>
4	Lëndë të tjera	8	3	1	0	0	5	<b>7</b>
5	Komuna paditëse/kreditore	0	0	0	0	0	0	<b>0</b>
	Gjithsej:	<b>641</b>	<b>978</b>	<b>1</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>5</b>	<b>1603</b>

**2. PASQYRA E AKTIVITETEVE SIPAS REGJISTRAVE PËR PERIUDHËN RAPORTUESE**

PARASHTRESA TË PRANUARA	CIVILE	PËRBARIMORE	KONFLIKTE ADMINISTRATIVE	CIVILE NDRYSHME	P_Athezionit	Komerciale Ekonomike	GJITHSEJ:
Aktvendim+Aktgjykim I	478	5	0	1	0	0	<b>484</b>
Aktvendim+Aktgjykim II	70	2	1	1			<b>74</b>
Aktvendim+Aktgjykim III	4		0	0			<b>4</b>
Aktgjykim+Aktvendim DHPGJS	0						<b>0</b>
Urdhër përbarimor		920					<b>920</b>
Aktvendim E për lejimin e përbarimit		0					<b>0</b>
Aktvendim për 180 ditë	0						<b>0</b>
Padi me prova	595		0	0			<b>595</b>
Aktvendim për përgjigje në padi	0		1	0			<b>1</b>
Përgjigje në ankesa C	23		0	0			<b>23</b>
Përgjigje në ankesa P		1					<b>1</b>
Përgjigje në prapësim		0					<b>0</b>
Përgjigje në revizion	1						<b>1</b>
Përgjigje në propozim për ML-në	0						<b>0</b>
Precizimi i padisë	44		0				<b>44</b>
Prapësim i debitorit		0					<b>0</b>
Ankesë C e paditësit	6						<b>6</b>
Ankesë P e kreditorit		1					<b>1</b>
Revizion C i paditësit	0			0			<b>0</b>
Ekspertizat	4	2		0			<b>6</b>
Aktakuza					0		<b>0</b>
Parashtrësata e tjera	4	1		0			<b>5</b>
	<b>1229</b>	<b>932</b>	<b>2</b>	<b>2</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>2165</b>

PARASHTRESA TË DËRGUARA	CIVILE	PËRMBARIMOR E	KONFLIKTE ADMINISTRATIVE	CIVILE NDRYSHME	P_Athezionit	Deperatamenti Ekonomik	GJITHSEJ:
Ankesat	160	1	0	0	0	0	161
Përgjigje në ankesa	0		0	0			0
Përgjigje në padi	576		0	0			576
Mbrojtje në padi DHP GJS	0						0
Revizion	5						5
Përgjigje në revizion	0		0				0
Propozim për ML-në	2		0				2
Përgjigje në ML	0						0
Prapësimet		11					11
Përgjigje në prapësim		0					0
Ushtrimi i kundërpërbarimit		2					
Ushtrimi i padisë	0						0
Kundërpadi	1						1
Kallëzim Penal					0		0
Ushtrimi i propoz. për përmbarim	0	0					0
Parashtresat e tjera	5	1	0	0	0	0	6
Gjithsej:	749	15	0	0	0	0	762

Seancat gjyqësore gjatë vitit 2023	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Gjithsej:
Nr. i seancave të mbajtura:	6	5	11	11	10	1	0	0	0	0	0	0	57
<b>Sipas kontesteve - seanca të caktuara/mbajtura</b>													
Civile													55
Përmbarimore													0
Konflikte Administrative													1
Civile, Ndryshme													1
Proc. At_hezionit													0
Gjithsej:													57

**DREJTORIA PËR ADMINISTRATË**

Raporti gjashtëmuor i Drejtorisë për Administratë ndahet sipas sektorëve si në vijim:

**Spektori i Gjendjes Civile**

Gjatë këtij gjashtëmuori janë lëshuar:

<b>Certifikata të lindjes</b>	<b>14088</b>
<b>Deklarata të bashkësisë familjare</b>	<b>788</b>
<b>Status martesor</b>	<b>751</b>
<b>Certifikata të martesës</b>	<b>1988</b>
<b>Certifikata të shtetësisë</b>	<b>88</b>
<b>Certifikata të vendbanimit</b>	<b>1248</b>
<b>Certifikata të vdekjes</b>	<b>532</b>
<b>Vërtetime nga Arkivi</b>	<b>550</b>
<b>Lindjet vendore</b>	<b>13</b>
<b>Lindjet e jashtme</b>	<b>75</b>
<b>Martesat vendore</b>	<b>196</b>
<b>Martesat e jashtme</b>	<b>7</b>
<b>Vdekjet vendore</b>	<b>24</b>
<b>Vdekjet e jashtme</b>	<b>14</b>
<b>Aktvdekjet</b>	<b>137</b>
<b>Pranimi i atësisë</b>	<b>24</b>
<b>Aktvendimet e korrigjimit të emrit ose të mbiemrit</b>	<b>24</b>
<b>Aktvendimet e regjistrimit të mëvonshëm të të lindurve</b>	<b>24</b>
<b>Aktvendimet e regjistrimit të mëvonshëm të të vdekurve</b>	<b>7</b>
<b>Aktevendimet e ndërrimit të emrit dhe të mbiemrit</b>	<b>16</b>
<b>Anulimet e regjistrimeve të dyfishuara me aktvendim</b>	<b>1</b>
<b>Aktvendimet e reregjistrimit të të vdekurve</b>	<b>1</b>

**Aktvendimet e reregjistrimit të të lindurve****3**

Të hyrat financiare në Drejtorinë e Administratës së Përgjithshme për 6-mujorin e parë të vitit 2024 janë: 33,132.00

**Sektori për Punë të Kuvendit dhe të Komiteteve**

Për të gjitha takimet e mbajtura të Kuvendit Komunal dhe të Komiteteve, kemi bërë përgatitjen profesionale të dokumenteve, përkthimin, lektorimin, kemi asistuar në mbarëvajtjen e seancave, kemi bashkëpunuar me Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, ku kemi dërguar aktet e miratuara në Kuvendin e Komunës.

Mbledhje të rregullta të Kuvendit	6
Komiteti për Politikë dhe Financa	6
Komiteti për Komunitete	4
Mbledhjet e KKS-së	3
Komiteti për Shëndetësi	2
Komiteti për Arsim	0
Komiteti për Auditim	1
Mbledhje të Jashtëzakonshme	0
Mbledhje Emergjente	0
Mbledhje Solemne	1
Mbledhje Komemorative	1

**Sektori për IT**

Kemi bërë rikonfigurimin, inspektimin e kompjuterëve, të punëve në sistemin e intranetit, kemi monitoruar funksionimin e faqes ueb, po ashtu, me kërkesa të ndryshme, edhe kemi publikuar materiale në faqen ueb. Të gjitha takimet të mbajtura në sallën e kuvendit komunal (mbledhjet e Kuvendit Komunal, të KPF-së, të KKS-së dhe të të gjitha komiteteve të tjera, i kemi përkrahur dhe, sipas nevojës, i kemi transmetuar në faqen ueb të Komunës.

Kemi zhvilluar procedurat për ndërtimin e dy E-Kiosqeve.

Kemi mbikëqyrur funksionimin e pajisjeve për printim, kopjim dhe skanim.

Vazhdimisht kemi kërkesa AD-HOC nga zyrtarë komunalë, nga shkollat e komunës së Rahovecit, nga institucionet shëndetësore (QKMF, QMF, AMF), për intervenime në pajisjet e teknologjisë informative.

### Qendra për Shërbime me Qytetarë

Kryen veprime të shërbimit administrativ, si: pranimin e kërkesave/parashtresave nga qytetarët dhe subjektet e tjera. Në Drejtorinë për Administratë të Përgjithshme, janë pranuar kryesisht kërkesa që kanë të bëjnë me drejtoritë e tjera e që, sipas rregullores për taksa, tarifa, gjoba dhe ngarkesa, kanalizohen përmes Drejtorisë për Administratë.

Drejtoria për Administratë	Shenja e klasifikimit	Nr. i kërkesave	Të paguara	Të liruara	Gjithsej
Kërkesa/Ankesa	320/04	3764	2544	//	3764
Mbajtës familjeje	320/04	602/10euro	602	//	6020
Vërtetime të ndryshme	320/04	84	84		84
Totali					9868

### Spektori për Mirëmbajtje, Logjistikë dhe Sigurim të objekteve

Ky sektor është marrë me rregullimin e çështjeve logjistike (pastrim, kujdes për gjelbërim etj...). Kemi përfunduar procedurat për projektin: Sigurimi fizik i objekteve të komunës.  
-Menaxhimi i automjeteve (mirëmbajtje, servisim, sigurim dhe regjistrim të automjeteve).

### Spektori për të Drejtat e Njeriut

Ka bashkëpunuar me organizata të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare, ka këshilluar qytetarët të cilët janë paraqitur në zyrë.

Ka punuar me theks të veçantë kundër diskriminimit të të gjithë qytetarëve të komunës së Rahovecit, pa dallim etnie e gjinie.

### Spektori për Barazi Gjinore

Zyrtari për barazi gjinore është angazhuar në promovimin dhe të drejtat e grave, për mosdiskriminim në baza gjinore në asnjë fushë, për të drejta dhe detyrime të barabarta të gruas, ashtu siç parashihen me ligjet tona në fuqi dhe me konventa ndërkombëtare.

Zyrtari ka bashkëpunuar me organizata vendore dhe të huaja. Është punuar në objektivin për rritjen e rolit të gruas në shoqëri, avancimin e saj në të drejtat që i takojnë.

## DREJTORIA PËR FINANCA DHE BUXHET

### 1. SEKTORI PËR BUXHET DHE FINANCA

#### 2. BUXHETI 2024

➤ **Buxheti i Komunës së Rahovecit për vitin 2024, ndahet në dy fonde burimore:**

- Grandi qeveritar .....18,189,822.00 €
  - Të hyrat vetanake .....1,614,904.00 €
- Gjithsej:.....19,804,786.00 €

➤ **Buxheti për vitin 2024, i shpërndarë sipas kategorive ekonomike:**

- Paga dhe Mëditje .....10,407,314.00 €
- Mallra dhe Shërbime.....2,466,340.00 €
- Shpenzime Komunale .....390,000.00 €
- Subvencione dhe Transfere .....890,000.00 €
- Investime Kapitale.....5,651,132.00 €
- Rezerva.....000.000.00 €
- Donacion.....000.000.00 €

➤ **Gjatë kësaj periudhe, kemi realizuar këto detyra:**

- Zotime, pranime, shpenzime për Mallra dhe Shërbime, shërbime komunale, subvencione dhe transfere, investime kapitale, përgatitje e ndryshimeve në listën e pagave për punëtorë.
- Bartja e të hyrave vetanake nga viti 2023, në vitin 2024.
- Shpërndarja e faturave të tatimit në pronë
- Raportimi i obligimeve financiare dhe kontraktuale në baza mujore, në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve.


**4. JANAR- QERSHOR - BUXHET, ALOKIM, SHPENZIM**

Përshkrimi	Lëndët e kryera	Buxheti fillestar	Buxheti final	Alokimet	Shpenzimet	Shpenzim/Buxhet fillestar %	Shpenzim/Buxheti final %	Shpenzim /Alokim %
Paga dhe Mëditje	-	10,407,314.00	10,407,313.56	6,442,559.78	5,605,154.97	53.86 %	53.86%	87.00 %
Mallra dhe Shërbime	912	2,466,340.00	2,546,543.77	2,459,543.77	1,257,336.56	50.98 %	49.37%	51.12 %
Shpenzime Komunale	266	390,000.00	390,000.00	390,000.00	148,769.23	38.15 %	38.15%	38.15 %
Subvencione dhe Transfere	62	890,000.00	960,562.30	357,124.42	301,996.26	33.93 %	31.44%	84.56 %
Investime Kapitale	72	5,651,132.00	6,295,196.89	5,802,480.30	3,511,652.73	62.14 %	55.78%	60.52 %
Rezervat (për zbatimin e ligjit të pagave)	-	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00%	0.00%	0.00%
Donacione	-	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00%	0.00%	0.00%
<b>Totali</b>	<b>1312</b>	<b>19,804,977.56</b>	<b>20,599,616.52</b>	<b>15,451,708.28</b>	<b>10,824,909.75</b>	<b>49.85%</b>	<b>47.93 %</b>	<b>63.90 %</b>

- Sqarim: Dallimi ndërmjet buxhetit fillestar dhe final është për arsye të bartjes së mjeteve të mbetura nga viti 2024, në kategorinë e investimeve kapitale, donacionet,

grandi i performancës, alokimi i huamarrjes në Arsim dhe Shëndetësi, në kategorinë e Mallrave dhe Shërbimeve, Rezervat.

#### 4.1. Paraqitja grafike



#### 5. TË HYRAT VETANAKE

- Të hyrat e përgjithshme vetanake, të planifikuara për vitin 2024, janë: 1,614,904.00 euro. Për këtë periudhë janë realizuar në shumë: 811,909.94 euro, apo 50.27% të planifikimit vjetor.

#### 6. SEKTORI I TATIMIT NË PRONË

- Gjatë periudhës janar-qershor 2024, Sektori i Tatimit në Pronë ka realizuar të hyra në shumën prej: 509,554.34 euro, apo 66.31% vjetor (planifikimi vjetor: 768,389.00). Regjistrimet e reja janë: 128 objekte ose 190,040.00 m<sup>2</sup>. Verifikimi i objekteve: 2006 ose ,351,937.00 m<sup>2</sup>.

### DREJTORIA PËR ARSIM

- Përgatitje e paramasave për dy projekte; projektin e furnizimit të shkollave me mjete konkretizime dhe laboratorike dhe projektin e furnizimit të bibliotekave të shkollave me libra;
- Orë letrare në kuadër të manifestimeve “Flaka e Janarit”;
- Gara Komunale të Olimpiadës së Fizikës, në të cilën morën pjesë nxënësit më të mirë të klasave 9, 10, 11, 12;
- Aktivitete me nxënës në nderim të 17 Shkurtit – Ditës së Pavarësisës së Kosovës;
- Shënimi i 1 Qershorit – Ditës Ndërkombëtare të Fëmijëve;
- Është punuar në sallën e edukatës fizike të ShFMU “Bekim Sylka”;



- Përrurimi i projektit të eficiencës së energjisë, ndërsa në Çiflak filluan punimet në rregullimin e fushës sportive në oborrin e shkollës;
- Rregullimi i nyjeve sanitare në objektet e shkollave në Drenoc, Senoc dhe në objektin e IAAP "Selajdin Mullaabazi-Mici";
- Marrëveshje bashkëpunimi me Shoqatën Profesionale të Informaticientëve të Kosovës (ShPIK) për fillimin e zbatimit të Projektit të Kodimit në Fushën e Teknologjisë Informatike;
- Furnizimi me inventarë i 3 çerdheve të reja dhe funksionimi i tyre;
- Fusha e re sportive në oborrin e ShFMU "31 MARS" në fshatin Gur i Kuq;
- Vizita sistematike mjekësore për fëmijët (nxënësit e klasave të para dhe të pesta);
- Bursa për nxënës dhe studentë.

## DREJTORIA PËR SHËNDETËSI DHE MIRËQENIE SOCIALE

- Shqyrtimi dhe përgjigjja me kohë në kërkesat e ndryshme të qytetarëve, kryesisht për ndihma momentale – financiare, prej të cilave, 260 janë të miratuara;
- Ofrimi i shërbimeve mjekësore në dy ndërrime në dy QMF-të, në Krushë të Madhe dhe në Ratkoc. Shërbimet mjekësore me dy ndërrime tanimë janë të përhershme;
- Shërbimi mjekësor "Kujdesi shtëpiak", për të moshuarit dhe ata me sëmundje të rënda, të cilët e kanë të vështirë mobilitetin deri te QKMF-ja apo QMF-të;
- Dhurimi vullnetar i gjakut;
- Ligjërata vetëdijesuese në QKMF në Rahovec;
- Në kuadër të marrëveshjes me AQH – në, po trajnohen mjekët dhe infermierët;
- Vizita sistematike të nxënësve në shkollat e komunës së Rahovecit;
- Personel shëndetësor për 42 vende të reja të punë: mjekë, stomatologë dhe infermierë;
- Funksionimi i aparatit të mamografisë, në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare "Fahredin Hoti" në Rahovec;
- Vaksinimi i fëmijëve.

### Ecuria e realizimit të projekteve kapitale

- Vazhdon furnizimi me barna nga lista esenciale, nga buxheti i Komunës;
- Vazhdon renovimi i objekteve të QMF-ve;
- Është bërë përrurimi i objektit të QMF-së, në Ratkoc.

### Mirëqenia Sociale:

Komisionet kanë punuar vazhdimisht në terren për evidentimin e familjeve në kushte të rënda sociale, dhe këto nevoja janë adresuar vazhdimisht në Qeverinë e Kosovës, donatorë vendorë dhe të huaj; janë kontaktuar shoqata të ndryshme dhe OJQ vendore dhe ndërkombëtare; është intervenuar në të gjitha rastet që është krijuar mundësia. Qendra për Punë Sociale dhe Organi i Kujdestarisë, kanë ndërmarrë të gjitha veprimet për ofrimin e ndihmës për personat në nevojë sociale, sipas procedurave të caktuara, në përputhje me mandatin ligjor.

### **Raport i shërbimeve në QKMF**

Gjatë kësaj periudhe, janë kryer gjithsej 53,534 shërbime, prej tyre:

- 7155 raste urgjente të trajtuara në sektorin e urgjencës;
- 29551 terapi intramsukulare;

- 8029 infuzione;
- 3035 shërbime në laborator;
- 1556 shërbime në Rtg cabinet;
- 188 mamografi;
- 1761 shërbime gjinekologjie;
- 1719 vizita shtëpiake;
- 530 vizita shtëpiake për nëna dhe fëmijë 0-3 vjeç;
- 10 lindje.

## DREJTORIA PËR EKONOMI, ZHVILLIM DHE TURIZËM

### Investimet kapitale:

- Marrëveshje bashkëpunimi me Ministrinë e Zhvillimit Rajonal, për realizimin e projektit “Ndërtimi i Ballkonit Panoramik mbi qytetin e Rahovecit”;
- Marrëveshje bashkëpunimi me Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë për financimin e parkut industrial në Optrushë, faza e dytë.
- Marrëveshje bashkëpunimi me Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, për bashkëfinancimin e projektit “Ndërtimi i shtandeve mobile për mbajtjen e panairove”;
- Në projektin: “Ndërtimi i lokaleve afariste zejtare në Rahovec”, kanë përfunduar pothuajse të gjitha punimet në objekt;

### Sektori për Ekonomi:

Janë përgatitur aktvendime për 739 biznese, të cilat, sipas kodeve ekonomike, ngarkohen me taksë afariste.

#### Të hyrat dhe ngarkesat në taksë komunale:

Nr.	Përshkrimi	Vlera në €
1	Të hyrat në taksë komunale, janar-qershor 2024	44,920.50€

### Sektori për Zhvillim:

Në periudhën janar-qershor 2024, janë lëshuar gjithsej 25 pëlqime të punës.

#### Të hyrat nga qiraja:

Nr.	Përshkrimi	Vlera në €
1	Të hyrat nga qiraja, janar- qershor 2024	36,145.80€

#### Tabela e kërkesave dhe e regjistrimit të bizneseve për periudhën janar-qershor 2024:

Nr.	Përshkrimi	Nr.
1	Biznese të reja	89
2	Informata të ndryshme	118
3	Vërtetim Individual	14

4	Shuarje të biznesit	10
5	Shuarje të njësisë	03
6	N.U.I.	33
7	Njësi e re	01
8	Certifikata duplikat	04
9	Ndërrimi i tipit të biznesit	03
10	Ndryshimi i bizneseve	52
11	Punë të tjera me palë	26
	<b>Gjithsej lëndë të përfunduara</b>	<b>353</b>

### Sektori i Turizmit

- Përmes bashkëpunimit me UNDP-në, është mundësuar praktikë 3-mujore për 3 kandidatë, dy nga kandidatët janë angazhuar në Komunën e Rahovecit dhe një në shoqatën "Hareja".
- Mbajtja e trajnimit "Standing Working Group (SWG) in the South-Eastern Europe", lidhur me promovimin dhe marketingun e turizmit përmes rrjeteve digjitale.
- Po ashtu, në vazhdimësi janë kryer punë të cilat i shërbejnë promovimit të turizmit në Komunën e Rahovecit.

### DREJTORIA PËR URBANIZËM, PLANIFIKIM DHE MBROJTJE TË MJEDISIT

Kërkesat për gjashtëmuajorin 2024:

JANAR – QERSHOR 2024					
Kërkesat	Nr.	Ap.	Re.	Sh.	Hidhet
Leje ndërtimi	28	25		2	1
Leje rrënimi	3	2		1	
Leje mjedisore	18	13	2	3	
Leje përdorimi	1	1			
Kushte ndërtimore	44	28	4	12	
Shkresë	56	46		9	1
Vërtetim	37	34	1	2	
Legalizim	5	3		2	
<b>GJITHSEJ:</b>	<b>192</b>	<b>152</b>	<b>7</b>	<b>31</b>	<b>2</b>

**Harta Zonale** - është përgatitur drafti, pas aprovimit të VSM-së, do të hapen rrugë per Hartën Zonale të Komunës.

**Sheshi Qendror** - punimet po vazhdonjë me mbushjen e stadiumit dhe ndërtimin e hyrjeve në parkingun nëntokësor.

Shtrati i përroit në Malësi të Vogël, punimet po vazhdonjë në aksin II.

Në Polluzhë punimet janë drejt përfundimit të shtratit të përroit dhe të urës.

Gjatë këtij viti ka përfunduar ndërtimi i parqeve në këto fshatra: Ofterushë, Drenoc, Brestoc, Xërxë, Kramovik dhe Reti e Poshtme.

## DREJTORIA PËR SHËRBIME PUBLIKE

- Mirëmbajtje e rrugëve dimërore;
- Mirëmbajtja e mjediseve;
- Krasitja e drunjve dekorativë në qytet dhe në vendbanime të tjera;
- Ka filluar ndërtimi i pritoreve per pritjen e udhëtarëve në qytet dhe pikat që janë përcaktuar në vendbanimet e komunës së Rahovecit;
- Kanë përfunduar kanalizimet në Lagjen “Vllëzërit Frashëri”, në Dejnë, në Çifllak, në Rahovec;
- Në ndërtim e sipër të pritoreve të vendkalimeve për udhetarë, në 16 pozicione;
- Ndriçim publik;
- Lirim i hapësirave publike;
- Marrëveshje me K.R.U. “Gjakova”, për investime të përbashkëta publike;
- Kontratë për zgjerimin e kamerave, që përfshin fazën e dytë - rrugën tranzite dhe fshatin Hoçë e Madhe;
- Kanë përfunduar segmente rrugore në disa vendbanime, si: Gur i Kuq - 5 rrugë, Sapniq - 6 rrugë, Pataqan i Poshtëm - 5 rrugë, Paqtan i Epërm - 2, Nashpall - 2, Ratkoc - 7, Rahovec - 2, Çifllak - 5, Nagac - 1, Brestoc - 2 dhe në Zaqisht - 3 segmente;
- Vendosja e kanalit atmosferik dhe zëvendësimi i gypit për ujë të pijshëm, në rrugën “Gëzim Hamza – Piktori”;
- Eleminimi i deponive ilegale të mbeturinave, pastrimi i hapësirave publike;
- Ndërtimi i troturarëve në vendbanimet: Sapniq, Drenoc, Fortesë dhe Brestoc;
- Ndërtimi i kanalit të kullimit në fshatin Dejnë;
- Marrëveshje mirëkuptimi në mes të Komunës dhe Ministrisë së Infrastrukturës për një projekt tjetër për asfaltimin e rrugës Sapniq-Nashpall.

## DREJTORIA PËR BUJQËSI, PYLLTARI DHE ZHVILLIM RURAL

Bujqësia, Pylltaria dhe Zhvillimi Rural, janë sektorët kryesorë, të cilët mund të kontribuojnë dukshëm në zhvillimin e përgjithshëm ekonomik të vendit. Përmes politikave dhe strategjive, tentojmë që të arrijmë një zhvillim të qëndrueshëm dhe një shfrytëzim shumë më efikas të resurseve natyrore të cilat i posedon komuna jonë.

**Disa nga aktivitetet më kryesore në këtë gjashtëmuor:**

- Pranimi i aplikacioneve për subvencionim të qumështit për gjashtëmuorin e dytë të vitit 2023 për fermerët blegtorë. Drejtoria e BPZhR-së pranon aplikacionet dhe i dorëzon në Ministri për pagesë;
- Është nënshkruar kontrata: “Furnizim me preparate për luftimin e insektit cikadia të hardhisë së rrushit”;
- Është nënshkruar kontrata me Qendrën Grumbulluese “Agro Celina”, e cila do të furnizojë bujqit me fidanë dhe inpute të tjera për kulturën e trangullit “kornishan”;
- Kemi përmbyllur raportin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore për vitin 2023, duke proceduar edhe në Kuvendin e Komunës;
- Veterinari i punësuar në DBPZhR, ka kryer vaksinimin e bagëtive të trasha dhe të imëta për të parandaluar sëmundjet infektive. Janë vaksinuar 1915 krerë lopë dhe rreth 7500 dele;
- Thirrja për aplikim: Përkrahja e fermerëve vreshtarë me preparate, për luftimin e insektit “cikadia” e hardhisë së rrushit. Gjithsej kanë aplikuar: 495 fermerë vreshtarë.
- 495 përfitues të preparatit për luftimin e insektit “cikadia” e hardhisë së rrushit.
- Rishpallja e thirrjes: Përkrahja e fermerëve vreshtarë me preparate, për luftimin e insektit “CIKADIA” e hardhisë së rrushit – 82 përfitues.
- Gjatë muajit muajit maj është hapur thirrja: Përkrahja e fermerëve me PLEH ARTIFICIAL. Gjithsej kemi pranuar **1134** aplikacione. Komisioni është formuar për verifikim të aplikacioneve, i cili edhe është duke punuar në këtë drejtim.
- Është hapur thirrja publike për subvencionimin e OJQ-ve për organizimin e festivaleve tradicionale dhe kulturore si: Festa e Vjeljes së Rrushit – 7 shtatori dhe Agrofesta për vitin 2024. Afati për aplikim është deri më datë **14.6.2024**.

**Pagesat direkte - subvencionet 2024**

Është hapur aplikimi për pagesa direkte/subvencione për 28 nënsektorë dhe kultura bujqësore. Numri total i fermerëve që kanë aplikuar për vitin 2024 është: **3,099**.

**Tabela me të dhënat e kulturave bujqësore të ndara në sektorë dhe të shprehura në sipërfaqe me ha, për të cilat kanë aplikuar fermerët e Komunës sonë.**

Të dhënat e fermerëve		2022	2023	2024	Diferenca 2024/2023
Sektori i lavërtarisë		Sip. në ha	Sip. në ha	Sip. në ha	Sip. në ha
1	Grurë	2,006.21	<b>2,743.61</b>	<b>2520.53</b>	-223.08
2	Misër	1,578.94	<b>1,943.60</b>	<b>1875.96</b>	-67.64
3	Elb	4.05	<b>1.12</b>	<b>6.5</b>	5.38
4	Tërshërë	122.04	<b>80.01</b>	<b>99.9</b>	19.89
5	Thekër	0.00		<b>1.72</b>	1.72
Gjithsej		<b>3,711.24</b>	<b>4,768.34</b>	<b>4,504.61</b>	-263.73
Sektori i vreshtarisë		Sip. ne ha	Sip. në ha	Sip. në ha	
Lloji i kulturës					
1	Rrush	2,322.21	<b>2,274.57</b>	<b>2,216.29</b>	-58.28

2	Fidanë të hardhisë	149,900.00	124,000.00	127,000.00	3,000.00
<b>Sektori i Perimekulturës</b>		<b>Sip. në ha</b>	<b>Sip. në ha</b>	<b>Sip. në ha</b>	
1	Speca	695.30	616.41	695.30	78.89
2	Domate	11.48	9.66	17.41	7.75
3	Qepë	149.76	186.78	235.47	48.69
4	Hudhër	25.56	20.37	14.66	-5.71
5	Patate	166.35	189.22	260.02	70.80
6	Tranguj	0.43	0.74	0.61	-0.13
7	Karota	7.65	7.14	6.38	-0.76
8	Rrepkë	0.00	0.49	0.00	-0.49
9	Brokuli	0.25	0.00	0.30	0.30
10	Fasule	0.46	1.90	2.70	0.80
11	Panxhar	0.00	0.00	0.00	0.00
12	Lakër	144.20	70.65	134.97	64.32
13	Lulelakër	10.82	10.23	8.06	-2.17
14	Presh	0.20	0.00	0.57	0.57
15	Spinaq	0.84	0.48	0.85	0.37
16	Marule	0.64	0.90	1.68	0.78
<b>Gjithsej</b>		<b>1,213.94</b>	<b>1,114.97</b>	<b>1,378.98</b>	264.01
<b>Kungullore</b>		<b>Sip. në ha</b>	<b>Sip. në ha</b>	<b>Sip. në ha</b>	
1	Shalqinj	164.68	171.68	353.99	182.31
2	Pjepër	100.24	84.49	98.71	14.22
3	Kunguj	11.82	6.58	23.80	17.22
4	kungull i gjelbër	302.84	160.41	242.77	82.36
<b>Gjithsej</b>		<b>579.58</b>	<b>423.16</b>	<b>719.27</b>	296.11
<b>Sektori i Pemëtarisë</b>		<b>Sip në ha</b>	<b>Sip në ha</b>	<b>Sip në ha</b>	
1	Dardhë	6.63	7.81	3.46	-4.35
2	Luleshtrydhe	2.72	2.09	1.19	-0.90
3	Kumbull	54.86	62.65	49.92	-12.73
4	Mollë	8.96	10.26	8.70	-1.56
5	Arra	73.90	95.15	92.86	-2.29
6	Lajthi	10.77	9.22	9.52	0.30
7	Ftua	4.17	3.86	3.86	0.00
8	Mjedër	0.53	0.00	0.00	0.00
9	Pjeshkë	2.69	3.27	2.96	-0.31
<b>Gjithsej</b>		<b>165.23</b>	<b>194.31</b>	<b>172.47</b>	-21.84
<b>Sektori i Blegtorisë dhe i Shpezëtarisë</b>					
1	Bletë	4,245.00	4,793.00	5,276.00	483.00
2	Lopë	1,938.00	1,953.00	1,966.00	13.00
3	Dhi	248.00	167.00	150.00	-17.00
4	Dele	7,226.00	7,396.00	5,244.00	-2,152.00
5	Pula vojëse	59,100.00	60,260.00	52,000.00	-8,260.00

Nr.	Lloji i kulturës	Sip. në ha	Sip. në ha	Sip. në ha	
1	<b>BMA</b>	<b>16.51</b>	<b>8.54</b>	<b>10.96</b>	2.42
					0.00
<b>Perime në serra</b>					0.00
1	Perime	24.26	<b>27.21</b>	<b>28.77</b>	1.56

**Qentë Endacakë:**

Ka vazhduar aksioni për trajtimin e qenve endacakë. Jemi duke bashkëpunuar me përfaqësues të KFOR-it, LMT, lidhur me përkrahje për trajtim të qenve endacakë nga CIMIC-u gjerman.

**Projektet e investimeve kapitale:****Kanalet e kullimit**

**Kanali i kullimit në Ratkoc** – Është instaluar një segment i kanalizimit, në gjatësi prej 100 m, si dhe ka filluar pastrimi në pjesën nën hekurudhë. Do të fillojë edhe ndërtimi i urës për fermerë.

**Kanali i kullimit nga Shtavica deri në Fortesë** - Kanë vazhduar punimet në ndërtimin e kanalit. Aktualisht është duke u betonuar baza e kanalit, si dhe ndërtimi i skarpateve.

**Kanali i kullimit në Çifllak**- Ka përfunduar segmenti në lagjen e Thaqi, përballë hekurudhës, janë duke vazhduar punimet dhe e do të fillojë ndërtimi i urës në mes të fshatit.

**Kanali i kullimit Fortesë – Celinë** – janë duke vazhduar punimet në instalimin e gypave fi: 1000, në segmentin kryesor të këtij projekti.

**Pastrimi i përrenjve**

Kemi intervenuar në shumë lokacione, si: Rahovec (Rimnik), Nagac, Zoqisht, Kramovik, Xërxë. Aktualisht, është duke u pastruar përroi në dalje të fshatit Ratkoc. Po ashtu, sipas kërkesës së banorëve të fshatit Gexhë, jemi duke pastruar segmentin në hyrje të fshatit, në mes të fshatit Malësi e Vogël, deri më tani i patrajtuar ndonjëherë.

**DREJTORIA PËR GJEODEZI, KADASTËR DHE PRONË**

Gjatë periudhës gjashtëmujore të punës për të cilën po raportojmë, të tre sektorët e drejtorisë i kanë përfunduar këto punë:

Spektori:	Lëndët:	Shuma në €
Kadastër dhe Pronë	460	15,000€
Gjeodezi	210	10,522€
Referenti	1,950+50 (L.Z.)	7,000€
<b>Totali</b>	<b>2,620+50 (L.Z.)</b>	<b>32,522.00€</b>

- Pranimi i aplikacioneve të qytetarëve dhe të gjeodetëve privatë, për ndarje të parcelave, bashkim të parcelave, regjistrim të pjesës së ndarjes, regjistrim të hipotekave, çregjistrim të hipotekave, shitblerje, trashëgimi, falje, ndërrim të paluajtshmërisë, ndarje të bashkësisë familjare etj.;
- Kërkesa për certifikatat e pronës dhe kopje të planit;
- Pranimi i lëndëve për ndarje fizike, produkte si: koordinata, modifikime dhe punë të tjera të cilat janë kryer nga sektori i gjeodetëve;
- Kemi përgatitur materialin për dhënien e pronës me qira, interes të përgjithshëm, vendim për këmbim etj.;
- Përgjigje në kërkesat e personave juridikë dhe fizikë;
- Me kërkesë të qytetarëve/grupeve të interesit (komuniteteve), kemi përgatitur material për mbledhje të kuvendit;
- Me kërkesë të qytetarëve për falje të pronës private në pronë publike në të gjitha zonat kadastrale për hapje të rrugëve publike, në interes të përgjithshëm, gjeodetët kanë dalë në terren dhe kemi përgatitur dokumentacionet e nevojshme për zhvillimin e këtyre procedurave;
- Kërkesa drejtuar ministrive përkatëse për zhvillimin e procedurave për shpronësim të parcelave, ku është pompa e derivateve në qytet dhe parcela ku operon për momentin kafeneja “Hardhia”, procesi është në përfundim e sipër;
- Kemi mbajtur takime të rregullta me Agjencinë Kadastrale të Kosovës;
- Përgjigje në kërkesat e Zyrës Ligjore, sipas nevojës, për përfaqësime në procese gjyqësore;
- Sipas legjislacionit në fuqi, kemi përgatitur listën e veçantë dhe listën e përgjithshme të pronave, të cilat planifikojmë t’i japim me qira brenda vitit 2024.

## DREJTORIA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT

Aktivitetet që i përfshin drejtorja, janë: aktivitetet rinore, sportive, ruajtja e trashëgimisë kulturore, shfaqjet teatrale, muzikë, art etj.

- Mbështetje 29 OJQ-ve përmes thirrjes publike për subvencionim në vlerë pre, **189.400 euro**. Krahasuar me vitin e kaluar kemi një rritje mbi **17%** të subvencioneve.
- Aktivitete kulturore për nder të ditëve të shënuara historike
  - Investimet kapitale 2024:
  - Rregullimi i terreneve sportive, në: Krushë të Madhe, Xërxë, Dejnë, Çifllak, Guri i Kuq;
  - Projekti në ndërtimin e Qendrës Rinore dhe Kulturore në Rahovec;
  - Ndërtimi i Shtëpisë-muze “Bajram Curri”.

**Biblioteka komunale “Sulejman Krasniqi”-RAHOVEC** – mirëmbajtje e bibliotekës në mënyrë profesionale; Përpunimi fizik i materialeve bibliotekare; Klasifikimi dhe katalogimi i librit; aktivitete të ndryshme.

**PALESTRA E SPORTEVE “MIZAHIR ISMA”** – Zhvillohen turnirë të ndryshëm dhe gara në Superligën e Kosovës, në hendboll, futsall, ping-pong etj.

Drejtorja për Kulturë, Rini dhe Sport, përveç aktiviteteve të parapara për periudhën kohore janar-qershor 2024 është angazhuar në aktivitete dhe punë të ndryshme, si:

- Pranimi dhe shqyrtimi i lëndëve;
- Vizitë objekteve sportive;



- Takime me klube dhe shoqata sportive;
- Vizitë objekteve kulturore;
- Takim me rini dhe shoqata e organizata rinore;
- Organizimi i aktiviteteve kulturore, rinore dhe sportive;
- Monitorimi i aktiviteteve të subvencionuara nga DKRS-ja;
- Takime të rregullta në kuadër të DKRS-së.

## DREJTORIA PËR PUNË INSPEKTUESE

Në total, gjatë kësaj periudhe raportuese, janë realizuar afro 400 kontrolle inspektuese.

- Parandalimi i ndërtimeve pa leje; Lirimi i hapësirave publike; Mbrojtja e mjedisit; Luftimi i ekonomisë së zezë; Mbrojtja e konsumatorit.
- 34 biznese të reja janë regjistruar në zyrën e ARBK-së, pas urdhërave nga shërbimi ynë;
- 34 pëlqime të punës për subjektet afariste të cilat i kanë plotësuar kushtet higjienike – teknike;
- Janë inspektuar 52 biznese nga inspektorët e tregut lidhur me identifikimin e produkteve ushqimore me afat të skaduar, vendosjen e çmimeve në produkte etj;
- Është bërë verifikimi periodik i peshoreve në furrat e bukës;
- Janë inspektuar 68 objekte ndërtimore të kategorisë së parë, po ashtu është bërë inspektimi i dokumentacionit teknik (projekti i ndërtimit, lejet e ndërtimit, janë shqiptuar 40 gjoba mandatore për ndërtim pa leje, si dhe janë obliguar që të pajisen me leje ndërtimore, 72 prej tyre kanë paraqitur kërkesë për leje, 25 janë pajisur me leje dhe 28 janë pajisur me kushte ndërtimore; 12 janë në proces, pra total 72 aplikime;
- në vazhdimësi kemi përcjellë nga afër punën e kompanive të licencuara të autobusëve;
- rrënimi i një muri në qytetin e Rahovecit, një shtëpie në qytetin e Rahovecit, janë rrënuar edhe dy objekte në fshatin Xërxë, si dhe janë rrënuar dy objekte në fshatin Krushë e Madhe, që të gjitha këto hapësira publike tashmë të lira për shfrytëzim nga qytetarët;

### STATISTIKA – GJOBA MANDATORE DHE REALIZIM I TË HYRAVE

LLOJI I NDËSHKIMIT	NUMRI I GJOBAVE TË SHQIPTUARA	VLERA E GJOBËS NË €
GJOBA MANDATORE PËR NDËRTIM PA LEJE	40	16,900.00€
GJOBA MANDATORE – ÇËSHTJE KOMUANLE	7	1200€
GJOBA MANDATORE PËR MOSRESPEKTIM TË ORARIT TË PUNËS	8	400 €
GJOBA MANDATORE PËR MJEDIS	23	1375 €
<b>TOTALI:</b>	<b>52</b>	<b>19,875.00€</b>

LLOJI I VEPRIMIT	NUMRI I KËRKESAVE	VLERA NË €
KËRKESA PËR KONTROLL INSPEKTUES	17	170 €
PËLQIME PUNE	34	510 €
<b>TOTALI:</b>	<b>51</b>	<b>680 €</b>

<b>TOTALI I TË HYRAVE NË DPI :</b>	<b>JANAR – QERSHOR 2024</b>	<b>20,555.00€</b>
------------------------------------	-----------------------------	-------------------

**DREJTORIA PËR MBROJTJE DHE SHPËTIM**

- Janë inspektuar lumenjtë, përroskat dhe kanalet e hapura në të gjithë territorin e Komunës;
- Inspektimi i rregullt i objekteve publike, private dhe shëndetësore për verifikimin e gjendjes së aparateve për shuarjen e zjarreve;
- Është kryer servisimi i parë për vitin 2024 i aparateve për fikjen e zjarrit në 70 objekte publike të komunës, janë servisuar gjithsej 558 aparate të vendosura në këto objekte: në objektet e Komunës së Rahovecit dhe të zyrave të Administratës, në të gjitha shkollat fillore dhe të mesme, çerdhe, QKMF dhe QMF-të, Shtëpitë e Kulturës, muzetë dhe në palestrën e sportive.
- Janë hartuar dy dokumente të rëndësishme:
  - Dokumenti mbi Rreziqet dhe Masat e sigurisë për muajtë korrik dhe gusht;
  - Dokumenti për Ngritjen e Gatishmërisë Emergjente për muajtë korrik dhe gusht për vitin 2024;
- Ekipi i zjarrfikësve gjatë gjashtëmuorit të parë të vitit 2024, ka marrë 63 kërkesa për intervenime.

**PËRFUNDIM**

*Ky raport përmbledhës paraqet thekset kryesore të aktiviteteve që kanë ndodhur gjatë kësaj periudhe raportuese.*

*Raporti i punës për gjashtëmujozin e parë të vitit 2024, është dëshmi e respektit ndaj Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale, në frymën e transparencës, llogaridhënies dhe performances sa më të mirë komunale dhe u dedikohet të zgjedhurve nga qytetarët, monitoruesve dhe publikut të gjerë.*

*Mirëpresim kontributin e secilit që, përmes vërejtjeve, këshillave, plotësimeve apo të dobësive eventuale, që t'i bëjmë bashkërisht përmirësimet e nevojshme, në mënyrë që në të ardhmen ta bëjmë sa më mirë punën tonë.*

*Programi qeverisës dhe vizioni ynë për Rahovecin, me të gjithë së bashku, hap pas hapi, po jetësohet.*

*Bashkërisht me ekipin tim qeverisës, kemi vullnetin, gatishmërinë dhe energjinë e duhur, të jemi në dispozicion të qytetarëve, ashtu që Komuna e Rahovecit të përjetohet se është shtëpia e tyre dhe ofron të gjitha shërbimet e nevojshme për ta.*

*Jemi të vendosur për menaxhim të mirë të pronës publike, për të krijuar kushte sa më të mira dhe lehtësira për: zhvillim ekonomik, arsim, shëndetësi, bujqësi, infrastrukturë.*

*Gjithnjë do të angazhohemi të punojmë për të mirën e përgjithshme, pa dallim.*

*Ju faleminderit!*

Rahovec, qershor 2024

**Smajl Latifi**

---

Kryetar i Komunës